



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

N J O F T I M

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË NË PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONIN E
RREGULLUAR TË VETERINERIT SEZONI III**

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Veterinerit, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online gjatë periudhës **1 – 6 Tetor 2025**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania. Provimi do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH), në datën **13 Tetor 2025**. Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë ndryshime përtej orarit të publikuar.

Gjatë aplikimit online për pjesëmarrje në provimin e shtetit, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

1. *Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;*

** Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*

2. *Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*

3. *Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional, fatura e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, **brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga Urdhri Profesional**. Pagesa duhet të ruhet në formatin PDF me emërtesën “pagesa”.*

(linku për kryerjen e pagesës: <https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/>)

Pas ngarkimit në sistem të pagesës, lutemi që kandidatët të qëndrojnë në pritje të email-it të pranimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, pas zgjidhjes së shërbimit “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania, të zgjidhet opsioni “shtetas i huaj” dhe të plotësohen me saktësi fushat e kërkuara.

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia dhe me anë të kodit unik të gjurmimit, mund të gjurmojnë në çdo kohë statusin e aplikimit.

- Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi (Kartë identiteti ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
- Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:
 - ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
 - ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
 - ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
 - ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Programi orientues dhe fondi i pyetjeve të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të Veterinerit, gjenden të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al.

Për çdo problematikë që mund të hasni lidhur me aplikimin, lutemi t’i drejtoheni Urdhrit Profesional të Veterinerit.

Ju urojmë Suksese!